



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:034038
Datë: 06.09.2024
Numri i dokumentit: 06131291

PML.nr.555/2024

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Agim Maliqi kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Mejreme Memaj anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurit F. M., për shkak të veprës penale vrasje me dashje eventuale nga neni 172 lidhur me nenin 21 par. 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.554/2022 të datës 12.07.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1.DKR.nr.737/2024 të datës 02.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 06.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit F. M., anulohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.554/2022 i datës 12.07.2024 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1.DKR.nr.737/2024 të datës 02.08.2024, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

II. I pandehuri duhet të qëndrojë në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.554/2022 të datës 12.07.2024, të pandehurit F. M., për shkak të veprës penale vrasje me dashje eventuale nga neni 172 lidhur me nenin 21 par. 3 të KPRK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit për dy (2) muaj, nga data 13.07.2024 e deri me datën 12.09.2024, masa e paraburgimit i është vazhduar konform dispozitës së nenit 184 par. 1 dhe 2 pika 1.2.1 dhe 1.2.2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.1.DKR.nr.737/2024 të datës 02.08.2024, e ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit si të pabazuar dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit F. M. av. Labinot Buzuku, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërie si të bazuar, të ndryshojë aktvendimet e kundërshtuara dhe të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit ose ndaj tij të caktohet masa e arrestit shtëpiak, pasi që masa e paraburgimit i është vazhduar deri më tani pa asnjë bazë ligjore.

Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën KMLP.III.nr.231/2024 e datës 05.09.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet i e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale dhe pas vlerësimit të pretendimeve gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë thekson se aktvendimet e kundërshtuara janë të paarsyetuara dhe kundërthënëse me vetveten, u mungon vlerësimi i drejtë dhe i gjithanshëm i fakteve dhe rrethanave me rastin e konstatimit të ekzistimit të arsyeve ligjore për vazhdimin e paraburgimit. Të pandehurit masa e paraburgimit i është vazhduar pa asnjë bazë ligjore, duke shkelur në mënyrën më të rëndë të drejtat e të pandehurit.

Gjykata Supreme vlerëson se janë të bazuara pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit se aktvendimet e kundërshtuara me kërkesë janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën-par. 1.10, të KPP, pasi që gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë bërë përshkrimin e provave respektivisht nuk kanë dhënë arsye dhe nuk i kanë specifikuar rrethanat dhe provat konkrete kur të pandehurit ia kanë vazhduar masën e paraburgimit nga neni 184 par. 1 nën-par. 1.1, e 1.2, pika 1.2.1, dhe 1.2.2 të KPP.

Në aktvendimet e atakuara vetëm janë përshkruar veprimet pa e zbatuar dispozitën ligjore të nenit 184 të KPP, lidhur me kushtet e nevojshme e të veçanta për vazhdimin e paraburgimit, pa i specifikuar ato më detaisht dhe më konkretisht, e të cilat fakte të specifikuar e të konkretizuara,

do të arsyetonin dhe mbështesnin rrezikun e ikjes, ndikimit në prova dhe rrezikun e ndikimit në dëshmitarë.

Në arsyetim lidhur me rrezikun e ikjes thuhet se ekziston rreziku potencial që i njëjti mund të arratiset për t'iu shmangur organeve të drejtësisë me qenë se kemi të bëjmë me vepër penale me rrezikshmëri të lartë, për të cilën parashihet dënim i ashpër, dhe mbështetur në këto rrethana, të cilat vënë në pah rrezikun e ikjes apo edhe shmangies së thirrjeve nga gjykata dhe prokuroria, me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, rezulton se përmbushin standardet e kësaj baze ligjore për vazhdimin e masë së paraburgimit. Rrezikshmëria e veprës penale dhe ashpërsia e prejudikuar e dënimit si dhe se i pandehuri në këtë fazë të procedurës penale, do të fshehë, ndryshoj apo falsifikojë provat duke ndikuar në dëshmitarë (duke i cituar), pasi që të njëjtit janë zyrtarë policorë të të njëjtit stacion policor, rreziku për të ndikuar tek njëri tjetri është shumë i madh, nuk po dihet se çka do të ndryshojë apo falsifikojë apo a do të ndikohen dëshmitarët në njëri tjetrin apo i pandehuri në dëshmitarë, kur dihet fakti se të gjithë janë zyrtarë policorë dhe mundësia e ndikimit në ta e sidomos edhe fakti se procedura penale është në fazën e shqyrtimit gjyqësorë dhe se dëshmitarët janë dëgjuar, nuk janë baza për vazhdimin e masë së paraburgimit, sidomos fakti se i pandehuri ndodhet nën masën e paraburgimit nga data 19.02.2022 e tutje.

Në rivendosje, gjykata e shkallës së parë duhet t'i vlerësoj të gjitha rrethanat e rastit konkret, duhet të arsyetojë konkretisht vazhdimin e masës së paraburgimit, dhe nëse ka bazë, më pastaj të arsyetojë ku mbështetet rreziku real i ikjes, mundësia e ndikimit në prova si dhe dëshmitarë e pastaj të merr vendim në këtë çështje duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete lidhur me vazhdimin e masës së paraburgimit, respektivisht provat dhe arsyet konkrete e specifike që e mbështesin rrezikun e ikjes, ndikimit në prova dhe ndikimit në dëshmitarë.

Për këtë arsye, kolegji i kësaj Gjykate, konform nenit 438, paragrafi 1 pika 1.1, të KPP, aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.555/2024, me datë 06.09.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi